RisiAlbania
Partner for Growth

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkepunim DSC

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Rindërtojmë edhe më mirë: Mundësia për të ndërtuar një destinacion unik për turizmin e qëndrueshëm në Shqipëri në periudhën pas pandemisë Covid-19

Në vitin 2022 turizmi global do të vazhdojë rimëkëmbjen e tij të ngadaltë nga pandemia Covid-19. Rimëkëmbja e industrisë po shoqërohet më një konsensus në rritje në lidhje me faktin që Covid-19 do të ketë ndikim afatgjatë në industrinë e udhëtimit. Vetë sektori i udhëtimit do të ndryshojë ashtu si edhe kërkesa për udhëtime. Cilat do të jenë këto ndryshime dhe si mund të ripozicionohet industria e turizmit në Shqipëri, që jo vetëm të rimëkëmbet, por të rindërtohet e të bëhet edhe më mirë se më parë?

Ky rast studimor evidenton potencialin që ka Shqipëria për të zhvilluar një turizëm unik dhe të qëndrueshëm – si një formë turizmi që fokusohet si te promovimi i autentikes dhe konservimi i trashëgimisë kulturore dhe atraksioneve, po ashtu edhe te mbrojtja e mjedisit dhe atraksioneve, duke maksimizuar përfitimitet ekonomike dhe sociale për komunitet, në linjë edhe me Strategjinë Kombëtare të Turizmit.

Kërkesa për turizëm ka ndryshuar për shkak të Covid-19

Kërkesa për udhëtime po ndikohet thellësisht nga Covid-19 në periudhën afatshkurtër. Kjo nxitet nga një përzierje e perceptimeve në lidhje me riskun e konsumatorit, profilet e kërkesës së turistëve të parë që rifillojnë udhëtimet dhe ndryshimin rrënjësor të mënyrës së konsumimit të turizmit siç është reduktimi i numrit të udhëtimeve me distanca të gjata. Një anketë e Tur Operator në Shqipëri në vitin 2021 e realizuar nga RisiAlbania nxori në pah faktin që rimëkëmbja në turizëm ka të ngjarë të jetë shumë më e shpejtë në përvojat e udhëtimit që përfshijnë turizmin me grupe të vogla, turizmin më të ngadaltë, të aventurës si dhe turizmin rural; dhe më e ngadaltë për grupet më të mëdha, turizmin urban dhe udhëtimet që përfshijnë udhëtime të rëndësishme dhe qëndrime të shkurtra në secilin vend.

1. Studim i Këshillit Botëror për Udhëtimin dhe Turizmin, 2019
2.Objektivi 1 i Strategjisë Kombëtare të Turizmit 2019-2023
https://akt.gov.al/wp-content/uploads/2019/07/Strategjia-Kombetare-e-Turizmit-2019-2023

Në partneritet me:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Zbatuar nga:

HELVETAS ALBANIA

PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Por ndikimi i Covid-19 në turizëm ka të ngjarë të ndryshojë edhe kërkesën në një periudhë më afatgjatë. Ndalimi efektiv i turizmit global për shkak të Covid-19 i ka dhënë botës kohë për të ndaluar dhe për të menduar në lidhje me këtë industri që ishte rritur në mënyrë eksponenciale dhe ku shqetësimet për ndikimin e udhëtimit dhe turizmit në mjedis, komunitete dhe kultura lokale ishin gjithnjë e më shumë në qendër të vëmendjes. Ndërsa turizmi rimëkëmbet, konsumatorët do të jenë me shumë mundësi më të kujdesshëm për të shmangur rrezikun prej situates COVID-19 në një periudhë afatshkurtër, por nga ana tjetër, në një periudhë më afatgjatë, ata do të jenë në kërkim të përvojave të alternative. Këtu përfshihen përvojat që ofrojnë mundësi për eksplorim më autentik dhe ku përvoja e udhëtimit i shërben dhe nuk i dëmton komunitetet lokale, si dhe adreson shqetësimet në lidhje me ndryshimin klimaterik.

Figura 1: Cili lloj turizmi do të rikuperohet më shpejt nga Koronavirusi?

Turizmi i Qëndrueshëm - një alternativë unike globale në rritje

Turizmi i qëndrueshëm është një alternativë unike në rritje për ato destinacione që përqafojnë, ushqejnë dhe promovojnë forma të turizmit që janë më në harmoni me mjedisin, komunitetet dhe kulturat lokale. Kërkesa për produkte më të qëndrueshme udhëtimi që sjellin një nivel më të lartë ndërgjegjësimi mjedisor, autenticiteti dhe përfitimi për komunitetin dhe shoqërinë ka qenë gjithnjë e më mbizotëruese në analizën e trendit të industrisë së udhëtimit para pandemisë. Kjo kerkese ka të ngjarë të shfaqet më dukshëm në vitet në vijim - si nje përgjigje ndaj rivlerësimit të vendit dhe ndikimit tonë në planet, rëndësisë së udhëtimit në jetën tonë gjatë një kohe kur udhëtimet pothuajse janë ndaluar, dhe kërkesës në rritje për të udhëtuar më mirë.

Turizmi i Qëndrueshëm :

- Krijimi i benefiteve socio-ekonomike për komunitetet përmes punësimit dhe mundësive të fitimit të të ardhurave.
- Mbrojtja e mjediseve natyrore, jetës së egër dhe burimeve natyrore gjatë zhvillimit dhe menaxhimit të aktiviteteve turistike.
- Sigurimi i përvojave autentike turistike që respektojnë dhe ruajnë trashëgiminë dhe kulturën.

The Travel Foundation

Shqipëria ka potencial të fuqishëm për t'u pozicionuar si një destinacion i qëndrueshëm turistik

Faktorët që e vendosin Shqipërinë në një pozicion të favorshëm për të zhvilluar një alternativë unike dhe të konsoliduar për ofrimin e turizmit të qëndrueshëm janë të shumtë:

- **Shqipëria është destinacion turistik në zhvillim, që është 'më pak i njohur' se destinacionet e tjera brenda Evropës:** Për shumë njerëz, Shqipëria mbetet relativisht e panjohur dhe pritshmëritë në lidhje me atë që mund të ofrojë janë të pakta. Kjo krijon mundësinë e zhvillimit dhe promovimit të Shqipërisë si një destinacion i qëndrueshëm turistik.

- **Mjediset natyrore të paprekura:** Fushat, malet dhe lumenjtë e paprekur, jeta e kafshëve, shpendëve dhe bimëve në Shqipëri janë pasuri natyrore dhe të vlefshme.

- **Kultura autentike dhe e gjallë:** Historia e Shqipërisë ka formuar një kulturë unike të gjallë jo vetëm të aspekteve të tilla si kuzhina, muzika dhe kostumet, por edhe mënyra jetese brenda vendit që janë unike dhe të dallueshme.

- **Mikpritja e popullit shqiptar:** Ngrohtësia dhe pritja e popullit shqiptar mbetet aseti më i vlefshëm i vendit dhe pikërisht ai aset që mbështet përvojat autentike brenda komuniteteve.

- **Turizmi masiv kufizohet në hapësira të veçanta:** Megjithë rritjen e formave te turizmit masiv në disa zona bregdetare të Shqipërisë, një turizëm i tillë mbetet i kufizuar në zona më të ngushta, duke ofruar hapësirë të madhe për turizmin e specializuar autentik.

Turizmi i qëndrueshëm është i dobishëm për bizneset dhe ekonominë në një shkallë më të gjerë

Projekti RisiAlbania ka punuar në fushën e turizmit novator të qëndrueshëm në partneritet me 12 kompani turistike (tur operatore) shqiptare dhe me një destinacion për të zhvilluar dhe testuar një larmi produktesh turistike. Sipas kompanive pjesëmarrëse të udhëtimit tregu për turne të tilla të qëndrueshme është i fortë dhe gjithnjë në rritje.

Sipas një ankete me tur operatoret të udhëtimit në vitin 2020, niveli i besimit në suksesin e produkteve të qëndrueshme turistike ishte shumë i lartë, ku investimi i kompanive për zhvillimin e paketave te reja turistike (mesatarisht 21,700 € për kompani) është kthyer brenda 2 viteve nga nisja e tregetimit te tyre.

Këto paketa te reja turistike përfshijne turet eksperienciale kulturore dhe autentike të kombinuara me marshimin, shëtitjen me biçikletë dhe eko-turizmin (si vëzhgimi i shpendëve dhe kafshëve të egra). Produktet janë zhvilluar nga kompanitë tur operatore shqiptare në bashkëpunim me ofruesit e shërbimeve dhe komunitetet ne zonat rurale, si e dhe janë testuar me agjencitë turistike ndërkombëtare përmes panaireve nderkombetare të turizmit, dhe tureve familjarizuese.
Këta lloj tur operatoresh novator, pionierë të zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm, duhet të mbështeten dhe promovohen në mënyrë aktive (fuqishëm), si aktorët kryesorë për të nxitur ndryshimin në zonat dhe komunitetet rurale në Shqipëri.

Sipas përvojës së RisiAlbania gjate bashkepunimit me keto tur operatore, zhvillime të tilla kanë vendosur kufij të rinj për turizmin në Shqipëri - in primis duke orientuar drejt turizmit biznese apo komunitete në zonat rurale, te pa rrahura nga turizmi ose ku numri i turistëve ka qenë shume i ulët. Si rezultat eshte vene re nje rritje e bizneseve rurale sic jane bujtinat apo hotelet, restorantet, agroturizmet, prodhuesit lokal dhe udherrefyes turistik, qe perkthehet ne me shume te ardhura edhe punesim per keto komunitete. Biznese më të forta dhe ekonomitë e larmishme rurale çojnë edhe në reduktimin e migrimit të të rinjve nga zonat rurale në qytete dhe jashtë vendit.

Figura 2: Rezultatet e partnerëve të RisiAlbania për turizmin e qëndrueshëm 2013-2021

Një nismë tjeter e ndërmarrë nga RisiAlbania për të mbështetur bizneset turistike në zonën e Gjirokastrës, ka qene mbeshtetja per krijimin e partneritetit per menaxhimin turistik te destinacionit te Qarkut te Gjirokastres, Shoqatën Visit Gjirokastra. Ky bashkepunim, nder te tjera, ka ne fokus zhvillimin edhe shtrirjen e turizmit edhe ne zonat rurale, zgjerimin e ofertës turistike, duke rritur numrin mesatar të netëve të qëndrimit të turistëve edhe sasinë e parave të shpenzuara ne rajon.

Kjo nismë ka çuar në *formalizimin e 20 bizneseve të turizmit rural* për t'u bërë pjesë e Shoqatës Visit Gjirokastra për të promovuar turizmin rural dhe të qëndrueshëm.

Ndërtimi i turizmit të qëndrueshëm në Shqipëri - fokusi tek aksionet e përbashkëta midis strukturave private dhe publike

Përmes nismave të RisiAlbania, sektori i turizmit në Shqipëri, përfshirë tur operatoret dhe ofruesit e shërbimeve lokale, kanë qenë të gatshëm dhe në gjendje të inovojnë dhe investojnë për turizmin e qëndrueshëm.

Sidoqoftë, zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm kërkon një qasje të mire koordinuar midis aktoreve privatë edhe ato publikë.
Shqipëria mund të promovohet jo vetëm si një destinacion fantastik për turizëm të pastër bregdetar, malor dhe kulturor, por edhe si një destinacion i qëndrueshëm dhe i përgjegjshëm turistik ku turistët mund të kontribuojnë për mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e kulturës, me përfitim më të gjerë social.

Disa nga fushat ku koordinimi i punës së aktorëve publik me ato privat mund të jetë më i dobishëm janë si më poshtë:

- Zhvillimi i një strategjie që specifikon llojet e turizmit të qëndrueshëm që mund të mbështeten dhe promovohen krahas turizmit masiv;
- Promovimi në shkallë ndërkombëtare i paketave të turizmit të qëndrueshëm në panairet ndërkombëtare ku marrin pjesë MTM ose AKT;
- Lehtësimi i kërkesave fiskale për bizneset rurale që fillojnë të bashkëpunojnë me operatorët turistikë;
- Angazhimi i vazhdueshëm tur operatoret e specializuar dhe partneret e tyre rurale për të garantuar që kriteret e financimit të përcaktuara në skemat e granteve publike si IPARD ose AZHBR të plotësojnë nevojat e bizneseve të përfshira në turizmin e qëndrueshëm.